

Raport lidhur me Projektet zhvillimore dhe Linjën e 10 hekurudhore për muajin shtator 2020.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përveç angazhimeve tjera të përditshme në realizimin e detyrave të parapara një vëmendje të posaçme ia ka përkushtuar edhe projekteve zhvillimore të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Projektet zhvillimore të INFRAKOS-it në ekzekutim e sipër gjatë periudhës raportuese janë:

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)
2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)
3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)
4. Ndërtimi i vendkalimeve elektrike në Linjën Hekurudhore (Fushë Kosovë – Pejë)

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 1: (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Gjatë muajit shtator është zhvilluar një numër i konsideruar i aktiviteteve rreth vazhdimin të punëve për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të hekurudhore në disa fronte pune përgjatë kësaj linje hekurudhore. Edhe pse ka pasur punime të përditshme, megjithatë vëllimi i punëve të realizuara nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar andaj është kërkuar angazhim shumë më i madh i kontraktorit për realizimin e punëve, ashtu që projekti të kryhet në afatin e paraparë (gusht 2021).

Punët e realizuara në këtë periudhë kohore kanë qenë të realizuara në stacionin Hekurudhor të Miradisë, në stacionin e Lipjanit, në atë të Ferizajt dhe në stacionin Hekurudhor të Kaçanikut. Vlen të përmendet se gjatë muajit shtator Kontraktori ka bërë edhe dërgimin e materialit (pjesëve të infrastrukturës) përfshirë këtu balastin për shtrirje në binarë, traversat e betonit dhe materialit tjetër përforcues për binarët hekurudhor.

Në vijim është bërë prezantimi me fotografi i disa nga punët e kryera gjatë muajit shtator 2020:



Pastrimi i terrenit për kanalin anësor



Pastrimi i terrenit tek hyrje-dalja e Tunelit 3




Deponimi i traversave në Stacionin e Gurëzës



Bartja e traversave në punishte, Ndalesa në Hashahaj



Deponimi i ballastit



Platforma e ndalesës në Hashahaj



Punët në kilometrin 257+700 – 258+160



Shtresat e ngjeshura



Testimi i shtresave të trupit të hekurudhës



Gërmimet në Ferizaj




Teste provuese për dheun




Demontimi dhe largimi i ndërrueseve ekzistuese në Stacionin e Miradisë



Vendosja e Ballastit



Shtrirja e traversave



Vendosja e binarëve të ri



Vendosja e shtresës së bitumenit



Ura 20, Rregullimi i shtratit të lumit

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 2: (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Komisioni vlerësues mbi bazën dhe instruksionet e kompanisë mbështetëse të Njesisë Për Implementimin e Projekteve dhe të procedurave të përcaktuara nga BERZH-i dhe BEI për procesin e vlerësimit edhe gjatë muajit shtator ka vazhduar punën dhe është në vazhden e vlerësimit të ofertave për përzgjedhjen e kompanisë punëkryese. Procesi po shkon me dinamikën e planifikuar, kushtet në të cilat po punon komisioni janë shumë të mira, ndërsa gjatë tërë kohës komisioni mbështetet edhe nga kompania konsulente Egis International e cila me ekspertizën e saj e mbështetë komisionin vlerësues.

Gjatë muajit shtator, respektivisht me datën 15.09.2020 është themeluar komisioni i cili e ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare për tenderin me titull “Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore: Shërbimet e konsulencës për mbikëqyrjen e ndërtimit të rehabilitimit të fazës II të Linjës së 10-të Hekurudhore (Seksioni: Fushë Kosovë – Mitrovicë). Ky komision i ekspertëve po ashtu është duke punuar sipas procedurave të BERZH-it dhe BEI0-së dhe i mbështetur nga këshillat e kompanisë konsulente Egis International e cila me ekspertizën e saj e mbështetë komisionin vlerësues.

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 3: (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë)

Pas realizimit të video konferencë me udhëheqësin e konzorciumit të IPF9 për hartimin e Dizajnit të fazës së III (Mitrovicë - Leshak), ku u shpalosen kërkesat tona dhe pritjet tona nga IPF9, gjatë kësaj periudhe kemi kontaktuar edhe përfaqësuesit e IFICO e cila është e ngarkuar nga WBIF për hartimin e Termave të Referencës për projekt dizajnin detaj teknik të rehabilitimit të fazës së tretë të Linjës së 10-të Hekurudhore. Informatat e pranuar nga IFICO tregojnë se është duke u punuar në hartimin e Termave të Referencës të cilat pastaj do t'i dërgohen INFRAKOS-it për komente.

Projekt dizajni për sinjalizim dhe telekomunikacion për Linjën e 10-të Hekurudhore Faza (1+2): (Hani i Elezit – Fushë Kosovë - Mitrovicë)

Siç është thënë më herët Kompania e ngarkuar për realizimin e këtij projekt dizajni “Obermeyer Hellas Ltd” ka fundi i muajit korrik e ka përfunduar dhe e ka dërguar draftin final të projekt dizajni për rehabilitimin e pajisjeve sinjalo siguruese dhe ato të telekomunikacionit për fazën e parë dhe të dytë të Linjës së 10-të hekurudhore.

Ekipi i ekspertëve të INFRAKOS-it ka shqyrtuar me kujdes të gjitha materialet e dërguara dhe pas analizave të bëra ka dhënë komentet përfundimtare për këtë projekt dizajn të cilat komente i janë dërguar kompanisë përgjegjëse për hartimin e këtij projekt dizajni. Në muajin shtator është dërguar drafti i korrigjuar nga OBERMEYER HELLAS, por për shkak të tejkallimit të çmimit të paraparë në këtë projekt dizajn INFRAKOS ka kërkuar që kompania projektuese ta bënë edhe një herë rishikimin e çmimit të realizimit të projektit.

Në momentin që kjo të kryhet, INFRAKOS do të bënë publikimin e shprehjes së interesit për përzgjedhjen e kompanisë punëkryese. Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me kompaninë konsulente janë duke u hartuar Termat e Referencës për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse për sinjalizim dhe telekom për fazën (1+2).

2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)

Në krahasim me raportin e muajit (Korrik – Gusht) 2020, gjatë muajit shtator nuk ka pasur ndonjë zhvillim i cili vlen të theksohet. Gjatë këtij muaji ka pasur komunikime për çështje të ndryshme me kompaninë projektuese dhe ashtu siç është thënë më herët pritet që ky projekt dizajn preliminar të përfundojë deri kah fundi i vitit apo muaji mars i vitit vijues.

Gjatë këtij muaji janë përgatitur informata me të dhënat teknike për Linjën e 7-të Hekurudhore të cilat i janë dërguar Ministrisë së Infrastrukturës në mënyrë që të jemi të përgatitur për mundësinë e investimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e saj.

3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

Njëri ndër projektet e infrastrukturës hekurudhore i cili po ashtu financohet nga grantet e Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) është edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore (Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës), projekt ky i cili është i një rëndësie të veçantë për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

Gjatë muajit shtator kompania e angazhuar për hartimin e studimit të fizibilitetit (HILL International Konzorciumi IPF 7) kanë dërguar draftin final të studimit të fizibilitetit për ndërtimin e kësaj linje hekurudhore. Materiali i është dërguar ekspertëve të INFRAKOS-it dhe janë duke u dhënë komentet përkatëse nga ekspertët tanë dhe pritet që të përzgjidhet opsioni më i mirë i ndërtimit të kësaj linje hekurudhore ashtu që më pastaj të bëhet drafti final i këtij dokumenti.

4. Ndërtimi i vendkalimeve elektrike në Linjën Hekurudhore (Fushë Kosovë – Pejë)

Për projektin “Ndërtimi dhe sigurimi i vendkalimeve hekurudhore” është nënshkruar kontrata me datën 30.10.2018. Kontraktori apo punëkryesi është Grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh. “H-PROJEKT” nga Kosova dhe “ALTPRO” d.o.o nga Kroacia.

Ky projekt është financuar nga ministria e Infrastrukturës dhe sipas kontratës ko0rnizë ka qenë e paraparë që të bëhet sigurimi i dhjetë vendkalimeve, ndërsa deri më tani janë siguruar katër vendkalime automatike. Mirëpo duke pasur parasysh se nuk janë siguruar fondet e parapara, atëherë është kërkuar nga kontraktori që të mos vazhdohet më tutje përderisa nuk do të sigurohen fondet e nevojshme për sigurimin e vendkalimeve tjera.